



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

## Kuvendi i Komunës Klinë

### Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

01Nr 06-4027 /24

Klinë, dt 10.08.24 /24

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur, më 29.08.2024, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 16:00.

Mbledhjen e udhëhoqi Nënkyrytarja e komunës së Klinës, Marqe Tanushi-Selmanaj, e cila përshëndeti të gjithë anëtarët e KKSB-së dhe gjithë të pranishmit që ishin aty.

*Kryesuesja, prezantoi rendin e ditës:*

1. *Trajtimi dhe mbrojtja e pyjeve nga dëmtuesit ilegal;*
2. *Informatë për fillimin e procesit mësimor dhe çështja e sigurisë nëpër shkolla;*
3. *Informatë dhe analizë nga policia e Komunës së Kinës për çështjen e vjedhjeve dhe sigurisë së përgjithshme;*
4. *Identifikimi i hapësirave për çasjen e personave me nevoja të veçanta.*

*Pika 1.Trajtimi dhe mbrojtja e pyjeve nga dëmtuesit ilegal.*

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Temat që janë bërë në planin e punës, sigurisht, ne, fatkeqësisht edhe mund të mendojmë për zjarrin, por nuk është që është paraparë në plan. Është edhe rreziku permanent, jo vetëm i prerjes dhe dëmtimit, por i kemi parë kohën e fundit edhe pasojat të cilat kanë qenë edhe tragjike. Pyjet janë një burim i rëndësishëm natyror që kërkon mbrojtje nga dëmtuesit ilegal; masat për trajtimin dhe mbrojtjen e pyjeve përfshijnë monitorimin e rregullt të tyre, për të identifikuar dëmtuesit dhe shkatërrimet,

pastaj bashkëpunimi me autoritetet lokale dhe agjencitë mjedisore për të zbatuar ligjet kundër prerjeve ilegale dhe dëmtuesve të tjerë. Jam shumë e sigurt, që ju të gjithë e dini se vjen deri te dëmtimi, cilat janë masat dhe çfarë duhet bërë, ajo se çka na mungon neve gjithmonë është bashkëpunimi i individëve me organet e drejtësisë të cilët kontribuojnë në paraqitjen e personave të cilët e dëmtojnë pronën shoqërore apo private. Duke i shkatërruar pyjet, nuk dëmtohet vetëm pamja ose ana materiale, por, dëmtohet edhe ekosistemi, natyra, ajri e shumë dëme tjera që i shkaktojnë mjedisit. Komandanti i policisë na jep sqarimet më të mira në rastin e fatkeqësisë dhe vdekjes tragjike të punëtorit të zjarrfikësve, për të cilin shpreh ngushëllime dhe na vjen keq për rastin, sido që të jetë, situata, a ka vdekur në vendin e punës duke shuar zjarret, apo para se të fillojë, por është një tragjedi që uroj të mos ndodh sërisht, që për komunën tonë ka paraqitur një akt që uroj të mos përsëritet asnjëherë. Ajo që na mbetet neve është që përmes institucioneve tona, kryesisht të arsimit, të vetëdijesohen masat, që as mos të prehen pyjet, as mos të vihet zjarri, sepse dëmet janë më të mëdha sesa që mendohet.

**Z.Jeton Sokoli:** Përshëndetje për të gjithë, faleminderit për kryesinë e këtij takimi! Unë desha ta di se, a kemi ndonjë raport të veçantë për dëmtimin e pyjeve dhe gjendjen e tyre? Kemi situata të vazhdueshme ku sivjet ka pasur edhe zjarrvënie nëpër pyje e fusha, pastaj zjarri nuk pyet, nuk ka kufi. Nuk e di si ka qenë gjendja në tërësi ,por, kisha bërë apel që me vazhduar me marr masa ndaj këtyre personave që e bëjnë qëllimshëm, sepse ka raste kur gjobat jepen vetëm për një kohë të caktuar, pastaj harrohen, e në vendin tonë kemi të bëjmë me ne, pasi që çdo gjë kërkon vazhdimësi. Kështu që, i kisha inkurajuar organet e vendit që me vazhduar dhe me pasur dënlime të cilat kur na prek te xhepi ose burgu janë gjëra që vetëdijesohemi pak më shpejt, faleminderit!

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Faleminderit shumë, pastor! Para se komandanti ta merr fjalën, z.Elmi, keni ndonjë raport?

**Z.Elmi Zenunaj:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë nuk jam përgatitur me ndonjë raport të saktë të rasteve të zjarreve dhe prita që Drejtoria e Bujqësisë do të dal me ndonjë raport, por mesatarisht ne kemi pasur 7 deri në 8 raste në ditë, ku mbi 100 raste të intervenimeve i kemi pasur brenda muajit. Respekt dhe falënderime që keni konsideratë ndaj punëtorëve të zjarrfikësve të cilët me këtë staf, jo, por me dyfishin e stafit, s'kemi mundur të menaxhojmë dhe na ka dal në ndihmë edhe KFOR-i dhe Forca e Sigurisë së Kosovës në disa raste, të cilët i falënderoj për bashkëpunimin dhe ndihmën që na kanë dhënë!

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Faleminderit, shumë! Nëse ka dikush tjetër? Nëse jo, kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

## ***2.Informatë për fillimin e procesit mësimor dhe çështja e sigurisë nëpër shkolla.***

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Fjalën në këtë pikë ja kalojmë drejtorit të DKA-së.

**Z. Qemajl Sejdija, drejtor i DKA-së:** Përshëndetje, nënkyetare, faleminderit juve që keni marr pjesë! Komuna e Klinës e ka pranuar vendimin nga Ministria e Arsimit, se mësimi do të fillojë më 2 shtator, për shkak se më 1 shtator është e diel dhe është pushim. Kanë përfunduar të gjitha përgatitjet për fillimvit dhe të gjitha shkollat në komunën e Klinës do të jenë në gjendje t'i pranojnë nxënësit dhe të fillojë mësimi ashtu si na takon me ligj. Ne, para dy ditëve, së bashku me Kryetarin, kemi pasur takim me akterët që menaxhojnë shkollat, kemi pasur takim me drejtorët dhe me sekretarët dhe nga ta kemi kërkuar që të kenë kujdes për shkak të teksteve shkollore që edhe këtë vit Ministria e Arsimit ka vepruar njëjtë sikur vitin e kaluar. Drejtoria e Arsimit ka kërkuar që të jetë sa më afër te prindërit që çka do që ka ndonjë shqetësim ose ndonjë problem, për të aplikuar për tekstet shkollore. Unë mendoj që prapë jemi me vonesë; sot, gjatë ditës, nonstop kam pranuar prindërit që kanë hasur në probleme dhe se ende vazhdon problemi, por uroj që ky problem të jetë sa më i pakët. Si drejtor i Arsimit, nga drejtorët kam kërkuar që ata fëmijë ose prindërit që kanë pasur problem me aplikuar ose ndonjë problem të ndryshëm, kam kërkuar prapë të furnizohen me libra të vitit të kaluar.

Një diçka tjetër që duhet të diskutohet është që komuna e Klinës ka pasur rinvime të ndryshme në shumicën e shkollave, ka nevojë ende, por që çdo vit do të kemi intervenime në shkolla në mënyrë që të kemi kushte sa më të mira nëpër shkolla.

Diçka tjetër që duhet me ju informuar është se vitin që shkoj, kemi pasur një rezultat shumë të mirë të maturës dhe jemi një ndër komunat ku 76% kemi pasur sukses, që realisht nuk e kanë pasur edhe komunat e mëdha.

Sa i përket sigurisë në shkolla, ne, në çdo fillim të vitit shkollor kemi takime me policinë dhe kemi diskutime rrëth sigurisë sepse vështirësi të shumta kemi edhe te shkolla "Ismet Rraci" dhe gjithmonë e kam ngritur si shqetësim dhe falë bashkëpunimit që e kemi me policinë e komunës sonë, shpeshherë ju kam drejtuar edhe komandantit me kërkesa të ndryshme, sepse fatkeqësisht kemi prindërit të papërgjegjshëm që hynë edhe me vetura te shkolla dhe bllokohet; është një pjesë shumë e ndjeshme sepse kemi qarkullim të madh.

Ne, si Komunë, jemi të gatshëm të fillojmë këtë fillimvit dhe uroj vetëm të kemi suksese, për çka do që keni, unë jam këtu, faleminderit shumë!

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Faleminderit shumë, drejtor! Uroj që të kemi vit të suksesshëm e mbi të gjitha siguri për fëmijët tonë!

**Z.Jeton Sokoli:** Faleminderit, drejtor, për raportin! Unë desha ta di për problemet që kanë hasur prindërit për aplikimin; këto probleme a janë rrëth regjistrimit në E-Kosova ose rrëth mungesës së mosdijes së tyre? Sepse, nëse është kjo, çka kishim mundur të bëjmë ne, ndoshta me dërguar një komunikatë për prindërit që mos me i lënë fëmijët pa libra, ndoshta kishim mundur t'i asistojmë dhe ta zgjidhim problemin.

**Z. Qemajl Sejdija, drejtor i DKA-së:** Faleminderit shumë! Për atë kam pasur takim me drejtorë dhe i kam informuar dhe kam kërkuar që mësimdhënësit të jenë sa më afër nxënësve, dhe se kudo që ka nevojë, ne të intervenojmë dhe të ju ndihmojmë.

### *3. Informatë dhe analizë nga policia e Komunës së Kinës për çështjen e vjedhjeve dhe sigurisë së përgjithshme.*

**Komandanti, z.Ragip Bytyqi:** Faleminderit, nënkyetare, përshëndetje për drejtorin dhe për të gjithë të pranishmit! Në zonën tonë të përgjithësisë, mund të themi se dy muajt e fundit kemi kaluar shumë qetë, në përjashtim të zjarrvënieve. Fillimi i shpreh ngushëllime komandantit të zjarrfikësve për humbjen e kolegut i cili e ka humbur jetën duke shërbyer gjatë shërbimit, ka pësuar infarkt. Normalisht që për shkak të aktiviteteve të shtuara që i ka pasur, vdekja, besoj që keni dëgjuar, që është si pasojë e infarktit. Një humbje e madhe për juve dhe gjithë neve dhe qytetaret e Klinës!

Haptas ju përgëzoj për një punë të shkëlqyer dhe një angazhim të jashtëzakonshëm që e keni bërë e sidomos këtë muajin e fundit, sepse është një numër i madh i zjarreve që keni intervenuar, ku në këtë rast ne kemi inicuar edhe procedurën ku tre-katër persona i kemi arrestuar dhe kemi ngritur fletëparaqitje penale për shkaktimin e zjarreve. Normalisht që ato zjarre nuk kanë qenë të qëllimshme, kanë qenë aksidentale, po ne fatkeqësisht kemi qenë të obliguar t'i paraqesim fletëparaqitje penale, i kemi arrestuar dhe rastet i kemi dërguar në prokurori. E them me përgjegjësi shumë të lartë sepse jemi në muajin gusht dhe akoma statistikat e muajit gusht nuk i kemi përpunuuar, por sa i përket muajit korrik ka qenë relativisht muaj i qetë në krahasim me vitin e kaluar.

Mund të krenohemi sidomos te rastet e vjedhjeve e te ato të rëndat i kemi pasur vetëm 4 vjedhje të lehta dhe 1 vjedhje të rëndë; gjatë kësaj periudhe kohore janë shqiptuar 792 gjoba; aksidentet kanë qenë të ngjashme pothuajse sikur me vitin e kaluar; 31 aksidente, ku 8 kanë qenë me lëndime dhe 23 aksidente me dëme materiale; gjithsej 32 persona janë arrestuar, ku 20 persona janë ndalur me ndalime policore; janë konfiskuar 4 armë; 89 lloje të munitioneve të ndryshme; janë realizuar një numër i madh i asistimeve, qoftë komunale, qoftë institucioneve tjera; janë vetëm 2 raste të dhunës në familje.

Tani jemi në përfundimin e fazës së planit operativ për fillimin e vitit shkollor, jemi të përgatitur për ato vendet ku kërkohet asistim për ta bërë më të mirën e mundshme.

Sa i përket pikës së parë të shkatërrimit të pyjeve, ne, me kodin penal jemi të detyruar të hetojmë këtë dukuri në vazhdimësi. Kemi planin operativ për luftimin e kësaj dukurie por ta kemi parasysh se nuk jemi i vetmi institucion që duhet ta luftojmë këtë dukuri, edhe pse krahasuar me qytetet tjera, zona e Klinës njihet si zonë me më pak pyje. Ne lusim edhe qytetarët të na njoftojnë, sepse ne pothuajse javën e kaluar e kemi pasur një person të arrestuar për prerjen ilegale të pyjeve.

Kjo ishte në pika të shkurtra sa i përket çështjes së sigurisë, dhe mund të themi se gjatë situatave dhe kohës së bashkatdhatarëve, fluksit të madh të automjeteve dhe qytetarëve, kemi kaluar shumë mirë. Normalisht që këtu rol kanë luajtur edhe institucionet tjera dhe jo vetëm policia, që këtë sezonë verore ta kalojmë mirë dhe pa probleme, faleminderit!

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Faleminderit, komandant!

**Znj. Silvia Rashkoviq:** Përshëndetje, komandant! A mund të na japësh më shumë sqarime për rastin në Binq?

**Komandanti, z.Ragip Bytyqi:** Për këtë rast unë nuk kam informacion sot, dhe pasi të përfundojë ky takim, unë do të interesohem menjëherë dhe për rastin tuaj personal që është dëmtim i pronës. Rasti është nën hetime dhe nuk kemi ndonjë indikacion se kush e ka shkaktuar, por që hetimet nuk janë ndërprerë dhe nëse vijmë te ndonjë informacion

normalisht që ke me qenë e informuar.

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Faleminderit, komandant! A dikush diçka?

**Z.Dalibor Kojic:** A mund të kem ndonjë informacion për kishën në Krushevë të Madhe e cila para pak ditësh është thyer? Sigurisht që është thyer për vjedhje dhe ajo kishë nuk ka mundësi të ketë të holla ose diçka shumë të madhe sa për t'u dëmtuar; dhe a mund të kemi siguri më shumë nga ana e stacionit policor në Klinë, që t'i shtojë patrullimet dhe të mundohet t'i gjejë keqbërësit? Sepse është hera e dytë që dera është thyer!

**Komandanti, z.Ragip Bytyqi:** Ne, policia, kemi informacion për një rast, vjedhje e rëndë. Ne e kemi proceduar rastin dhe e kemi identifikuar personin e dyshuar, e kemi arrestuar dhe kemi ngrehur kallëzim penal kundër të dyshuarit; sa i përket rastit të dytë, ne, nuk kemi informacion.

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Faleminderit, komandant! A ka ndokush tjetër? Nëse jo, kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës.

#### *4. Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta.*

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Edhe vitin e kaluar jemi munduar që në pikë të shkurtra ta trajtojmë si temë e cila atakon personat që kanë probleme në qasje të institucioneve të ndryshme, qofshin shtetërore, apo private. Për të siguruar qasjen e personave me nevoja të veçanta në hapësira publike dhe institucione, duhet të bëhet një auditim i plotë i infrastrukturës ekzistuese, për të identifikuar barrierat që e pengojnë qasjen. Faktikisht, ne, edhe në objektin tonë komunal ku jemi, kemi problem për qasje në katin e dytë ose në katet tjera ku këta persona kishin mundur të kenë qasje, megjithatë, kur këta persona vijnë në një institucion, pjesa tjetër mundohet të ju ofrojë siguri ose t'ju ofrojë qasje në problematikat që kanë. Mirëpo, nëse ne si institucion kemi mundësi me ju ofruar në disa institucione tjera, është e mundshme të ju ofrohet ndihmë.

Problemet janë të shumta, kemi probleme edhe nëpër shkolla sepse jo të gjitha shkollat kanë qasje në katin e dytë ose në kabinete të ndryshme, mandej e dimë që në vendin tonë shkollat janë shumë të vjetra të cilat nuk e kanë këtë mundësi të qasjes, mandej, ndoshta problemet më të mëdha janë tek personat që janë të palëvizshëm, që janë me karroca, pjesa tjetër e personave me aftësi të kufizuar të verbër është edhe më vështirë të ketë qasje për tu identifikuar, mirëpo, si shoqëri kishte me qenë mirë që çdo njeri t'i raportojmë, të shohim se çka mund të bëjmë.

Unë, në bashkëpunim me Drejtoreinë e Inspektoratit, kam marr disa shënime; temat kanë qenë të takimeve të kaluara të cilat kanë bërë kërkeshë të vendosen disa shenja dhe problemet të cilat ndodhen në komunikacion të minimizohen. Unë do ta jap një raport, ky raport përfshin informata rreth procesit të punimeve që është e titulluar "shenjëzimi horizontal dhe vertikal" i cili është diskutuar shumë më herët dhe Drejtoria për Inspektorat bashkë me kompaninë "Elko Group" kanë vendosur 582m vendkalime të këmbësorëve-zebra; 61 shtylla për vendosjen e shenjave të komunikacionit; 30 shenja për lajmërimin e informimit të afërsisë së vendkalimit mbi hekurudhë; janë vendosur 30 shenja të komunikacionit si shenja të rrezikut të urdhëresave të prera si dhe; shenja të lajmërimit; janë vendosur gunga prej gome në 10 vende sipas kërkjesave të qytetarëve

për sigurinë e qytetarëve. Pra, të gjitha këto rrugë kanë qenë pronësi të komunës sepse e kemi diskutuar disa herë.

**Z. Qemajl Sejdija, drejtor i DKA-së:** Faleminderit shumë! Është një kategori që do shumë kujdes të veçantë. Ne e kemi rinoimin e shkollës komplet në Gllarevë dhe aty e pasq një qasje shumë të mirë përfëmijët me nevoja te veçanta; një lift i montuar që ju mundëson që ata të kenë mundësi të kenë qasje edhe në katin e dytë dhe kudo që është e nevojshme. Është një praktikë e mirë, që ne si Drejtori e Arsimit mund ta marrim dhe ta shikojmë atë kosto edhe me vazhduar nëpër shkollat e tjera, sepse është një lehtësim edhe për prindërit.

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Faleminderit, drejtor! Vlen të theksohet që Drejtoria e Arsimit, që nga viti i kaluar ka mësues që ndihmojnë fëmijët me nevoja të veçanta, dhe kjo është një e mirë që ju ofrohet fëmijëve që të jenë të barabartë me pjesën tjeter të nxënësve. Nëse dikush nuk ka diçka për të shtuar përfund, takimin e mbylli këtu, duke ju përshëndetur dhe falenderuar të gjithëve përpjesëmarrje!

Procesmbajtësja,  
Orgeta Sylaj



Zv. KRYESUESJA,  
Marqe Tanushi-Selmanaj

